



Prishtinë, 24 qershor 2008  
Kodi i ZRRE: D\_086\_2008

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në**

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080,
2. Kërkesën e Termokos SH.A për derogim në zbatimin e Neneve 35.2 të Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, të datës 10 janar 2008, **në seancën e mbajtur më 24 qershor 2008 ka nxjerrë këtë:**

**VENDIM**

- I. **Aprovohet kërkesa e** Termokos SH.A për derogim të afatit përcaktuar me Nenit 35.2 të Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë;
- II. **I lejohet** Termokos SH.A të zbatojnë shkycje kolektive nga data e lëshimit të këtij vendimi deri më 31 mars 2009.

1. Në janar të vitit 2008 Termokos SH.A ka bërë kërkesë për zgjatjen e afatit për shkycje kolektive të përcaktuar me nenin 35.2 të Rregullit për shkycjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë;
2. ZRRE ka vlerësuar kërkesën dhe argumentet e ndërmarrjes në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi;
3. Të gjitha dispozitat tjera të Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë do të mbesin në fuqi;
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe;
5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh prej miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ali Hamiti, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, anëtar